



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2022:023199

Datë: 20.11.2024

Numri i dokumentit: 06481233

PPP.nr.7/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega në Kaçanik, si gjykatë përmbarimore e shkallës së parë, gjyqtari Burhan Berisha, me bashkëpunëtorin profesional Ismail Kuçi duke vendosur në çështjen përmbarimore të kreditorit S. T. nga Komuna E Kaçanikut, të cilët me autorizim e përfaqëson Avokat N. R. nga Kaçaniku, rr. "...", kundër debitorit N.T.P "..."- "... .." B.I, me seli në magjistralen Ferizaj-Shkup, e duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, më dt.20.11.2024 morri dhe shpalli këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET, në tërësi si i pabazuar Prapësimi i debitorit, N.T.P "..."- "... .." B.I, me seli në magjistralen Ferizaj-Shkup, i ushtruar më dt. 21.01.2022, kundër Urdhërit Përmbarues me P.nr.45/2022 i dt. 10.01.2022.

II. DETYROHET, debitori që ta bëjë ekzekutimin e propozimit Urdhërit Përmbarimor P.nr.45/2022 i dt. 10.01.2022, lëshuar nga përmbaruesi privat Sh. L. me seli në Ferizaji, Rr."..." H2, banesa B, kati I-rë, n.5, si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës jokontestimore në shumë 679.00€ si dhe shpenzimet e përmbarimit të cilat i cakton përmbaruesi privat, kjo pagesë do të bëhet në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit në dorëzim të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Kreditorit S. E. T. nga Komuna E Kaçanikut, të cilët me autorizim e përfaqëson Avokat N. R. nga Kaçaniku, rr. “...” me datën 10.01.2022, ka ushtruar propozim për përmbarrim te përmbarruesi privat Sh. L. me seli në Ferizaji, Rr.”...” H2, banesa B, kati I-rë, n.5, kundër debitorit N.T.P “...”-“... ...” B.I, me seli në magjistralen Ferizaj-Shkup.

Me të cilin ka kërkuar që të lëshohet Urdhër dhe të lejohet përmbarrimi sipas propozimit dhe të detyrohet Debitori që në afat prej 7 ditësh, kreditorit të ja paguaj shumën e të hollave në vlerë prej 1,171.89€ si dhe shpenzimet e procedurës jo kontestimore në lartësi prej 679.00€ dhe ato përmbarrimore, duke bazuar në Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik C.nr.138/2018 të datës 23.11.2021 me numër të lëndës 2022:023200, për kompensimin e demit me kamatë që nga dita e parashtrimit të padisë nga ana e Kreditorit e deri në pagesën përfundimtare, i cili vendim është bër i plotfuqishëm me datë 18.03.2024 dhe i ekzekutueshëm me datë 06.01.2022, e tëra kjo përmes bllokimit te llogarive në cilëndo bankë qofshin ato të debitorit, si dhe regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme të debitorit deri në pagesën e borxhit, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore.

Përmbarruesi Privat më datë 10.01.2022, ka lejuar përmbarrimin ndaj debitorit N.T.P “...”-“... ...” B.I, me seli në magjistralen Ferizaj-Shkup, ndërsa me nga një kopje të propozimit është njoftuar debitori i cili në afatin e paraparë ligjorë ka paraqitur Prapësim.

Përmbarruesi privat një kopje të propozimit për përmbarrim së bashku me urdhërin për lejimin e ekzekutimit, me datën 10.01.2022 i’a ka dorëzuar debitorit, i cili më datë 21.01.2022, ndaj urdhërit përmbarrues ka paraqitur prapësim me të cilin i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet Urdhri P.nr.45/2022 i dt. 10.01.2022.

Debitori me prapësim i ka propozuar gjykatës, që prapësimi të aprovohet si i bazuar dhe të anulohet urdhëri i përmbarruesit privat nr. P.nr.45/2022 i dt. 10.01.2022, pasi që konsideron se Përmbarruesi Privat me rastin e lejimit të Urdhërit Përmbarrimor nuk i ka vlerësuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore, provat e paraqitura nga ana e Kreditorit, nuk kanë titull ekzekutiv me arsyetimin se: Propozimi Përmbarrimor të cilin e ka lejuar Përmbarruesi

Privat nuk është i ligjshëm dhe i rregullt dhe se i njëjti përmban shkelje te dispozitave të LPP-së. Bazuar në LPP-së, sipas nenit 21 dhe 29 , provat që kanë ofruara nuk mund të jenë të përmbarueshme, me ç'rast nuk mund të jetë objekt përmbarimi. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Ferizaj-Dega në Kaçanik C.nr.138/2018, i datës 23.11.2021, për arsyes se e njëjta gjykatë nuk e ka bërë ekspedimin te debitori por te personi i tretë pikërisht te djali i tij dhe i njëjti pretendon se nuk ka mundër të parashtrijë ankesë për shkak se i njëjti nuk e ka pranuar këtë aktgjykim. Por lidhur me të është njoftuar vetëm në ditën kur e ka pranuar Urdhrin Përmbarimor, dhe i njëjti ka kërkuar që të shtyhet përmbarimi konform nenit 61 të LPP-së, deri sa gjykata të vendos lidhur me propozimin për kthimin në gjendje të mëparshme, si dhe ka kërkuar që të caktohet seancë publike për administrimin e provave.

Mbi bazën e kësaj dhe në harmoni me nenin 71 te LPP-së i ka propozuar Gjykatës që ta aprovoj prapësimin dhe ta anuloj urdhërin për përmbarim.

Ndaj këtij prapësimi kreditori përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur përgjigjen në prapësim ku ndër të tjera ka theksuar se kundërshton Prapësimin për arsye se nuk është i bazuar dhe nuk përmban asnjërin nga shkaqet e parapara me nenin 71 par. 1 të LPP-së, ky prapësim nga ana e gjykatës duhet të refuzohet në tersi si pa bazuar dhe vlen të ceket se Aktgjykimi i nxjerrë nga Gjykata Themelore Ferizaj-Dega në Kaçanik C.nr.138/2018 i datës 23.11.2021, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 17.12.2021 dhe i ekzekutueshëm me datë 06.01.2022, pretendimi se Aktgjykimi C.nr.138/2018 i datës 23.11.2021, është pranuar nga djali i Debitorit dhe jo nga Debitori personalisht dhe se duhet detyrimisht që Aktgjykimi t'i dorëzohet personalisht sipas nenit 110 të LPK-së, këto pretendime nuk qëndrojnë, për faktin se sipas par.1 dhe par.2 të nenit 111 të LPK-së, lidhur me pranimin-dorëzimin e shkresave është precizuar sktë, po ashtu pretendimet e debitorit janë vetëm zhagjitje të procedurës dhe mosë përmbushjen e detyrimit sipas Aktgjykimit C.nr. 138/2018 të datës 23.11.2021.

Gjykata e refuzoj prapësimin e debitorit si të pa bazuar, për arsye se debitori prapësimin nuk e ka mbështetur në prova, asnjë provë nuk ja ka bashkangjitur prapësimi siç është paraparë me nenin 69 par.4 të LPP-së, si dhe nuk ka paraqitur asnjë nga shkaqet e parapara me nenin 71 nga pika 1.1 deri tek pika 1.2 të LPP-së.

Gjykata i analizoj edhe pretendimet e Kreditorit të paraqitura në propozimin për përmbarim dhe në përgjigje në prapësim dhe të njëjtave u falë besimin për shkak se ishin të drejta

dhe të ligjshme për të gjitha arsyet e cekura më lartë, Andaj edhe i propozoj Gjykatës Themelore Ferizaj-Dega Kaçanik që të Refuzohet Prapësimi i debitorit në tërësi si i pa bazuar, duke bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik C.nr.138/2018 të datës 23.11.2021 me numër të lëndës 2022:023200, i cili vendim është bër i plotfuqishëm me datë 17.12.2021 dhe i ekzekutueshëm me datë 06.01.2022,

Gjykata e analizoi prapësimin e debitorit si dhe shkresat e tjera të lëndës dhe gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar dhe të njëjtin e refuzoi si të pa bazuar, sepse pretendimet ankimore të debitorit të paraqitura si më lart jo vetëm që nuk kishin mbështetje provuese, por të njëjtat ishin të pa justifikueshme në aspektin ligjor.

Faktet e paraqitura nga ana e debitorit siç janë: Provat e paraqitura nga ana e Kreditorit, nuk kanë titull ekzekutiv me arsyetimin se: Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik C.nr.138/2018 të datës 23.11.2021 me numër të lëndës 2022:023200, i cili vendim është bër i plotfuqishëm me datë 17.12.2021 dhe i ekzekutueshëm me datë 06.01.2022, provat që kanë ofruara nuk mund të jenë të përmbarueshme, me ç'rast nuk mund të jetë objekt përmbarimi dhe nuk është i përshtatshëm për përmbarim në kuptim të nenit 27 të LPP-së, nuk përbëjnë shkak për aprovimin e prapësimin të paraparë me nenin 71 të LPP-së, andaj gjykata pretendimet e tilla nuk mund ti konsideroj të qëndrueshme.

Gjykata i analizoi pretendimet e debitorit të paraqitura me prapësim, mirëpo të njëjtave nuk ua fali besimin për këto arsye: Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Ferizaj-Dega në Kaçanik C.nr.138/2018 të datës 23.11.2021, është titullë ekzekutiv dhe ika të gjitha tiparet e përmbarueshmërisë

Mirëpo gjykata vërteton se propozimi për përmbarim është ngritur në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik C.nr.138/2018 të datës 23.11.2021 me numër të lëndës 2022:023200, i cili vendim është bër i plotfuqishëm me datë 17.12.2021 dhe i ekzekutueshëm me datë 06.01.2022, andaj vlerëson se janë përmbushur kriteret e përshtatshmërisë së dokumentit përmbarimorë.

Duke marrë për bazë gjendjen faktike gjykata rrjedhimisht konstaton se debitori nuk ka paraqitur asnjë nga shkaqet e parapara me nenin 71 nga pika 1.1 e deri tek pika 1.12 të LPP-së,

andaj gjykata duke i pasur për bazë të gjitha këto fakte të konstatuara vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e detyroi debitorin që kreditorit të i'a paguaj edhe shpenzimet e procedurës përbarimore në shumë të cilën do ti llogaritë organi përbarues, konform nenit 13. par.4 të LPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Dega në Kaçanik

PPP.nr.7/22 prej dt.20.11.2024

Gjyqtari:

Burhan BERISHA

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh ,nga dita e pranimit, ankesa i parashtrohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.